

Dr. Tariq Ramadan

Në brigjet e transcendencës*

Ndërmjet Zotit dhe njeriut

Në pjesën hyrëse të këtij libri ne konstatuam se për njerëzit e Perëndimit, Islami duket të jetë kundër çdo ideje të modernitetit. Pretendimet e këtilla ne i lexojmë në faqet e para të disa revistave amerikane, angleze e franceze kur ato rritjen e islamizmit e adresojnë me tituj të llojit *Islami ose moderniteti* dhe *Islami ose demokracia*.¹ Kjo është kështu kur formulimet nuk janë më ekskluziviste ose dënuese. Sfondi i krejt kësaj që po vizatohet është shprehja e një lloj ballafaqimi apo kundërvënie midis Islamit dhe Perëndimit. Një ballafaqim me ç'rast këtij të fundit i atribuohet një cilësi pozitive, e cila përfaqëson parimin e hapjes dhe të respektit ndaj vlerave humane dhe demokratike. Nga ana tjetër, Islami duket të jetë i damkosur nga arkaizmi dhe tradita, i drynosur në kategoritë e vjetra dogmatike, kërcënues për gratë, me një kod penal barbar (i reduktuar në termin *Sheri'a*) si dhe mohues i lirive njerëzore. Në prag të mileniumit të tretë të erës krishtere, termet e alternatives janë të qarta.

Kur ta shikosh gjendjen e shoqërive muslimane, është e pamundur që kritikën e drejtuar kundër nesh t'i fshish me një të goditur lapsi. Ato janë të mbështetura mirë kur dëshmojnë disa refleksione e sjellje të habitshme të cilat ne i justifikojmë në emër të Islamit. Ndër këto janë privilegjet e mbretërve dhe të presidentëve të shteteve muslimane, drejtësia e mbështetur në interesa, analfabetizmi i femrave bashkë me një varg diskriminimesh, secila më e dhimbshme se tjetra, tradicionalizmi i ngushtë i disa *ulemave* (dijetarëve islamë) të cilët vendosin dhe zgjidhin problemet larg çdo realiteti njerëzor në një absolutizëm që e merr vesh vetëm Zoti. Këto janë fakte dhe ne duhet t'i pranojmë e t'i kemi parasysh. Megjithatë, ne duhet të pyesim nëse debati mbi Islamin është nisur në baza të qarta e të shëndosha metodologjike. Të trajtohet e të merresh vetëm me ngjarjet tronditëse ditore, ose edhe më gjerë, me situatën e shoqërive muslimane, për të konkluduar, në një formë përfundimtare, se Islami nuk mund t'u përgjigjet problemeve bashkëkohore është edhe e pasaktë edhe reduktioniste. Kjo i kufizon (redukon) studimet islame (islamologjinë) me shkencat shoqërore, kurse specialistët e këtyre të fundit i bën specialistë të Islamit bashkëkohor.² Akoma më qartë, kjo është njësoj sikur të heqësh dorë nga një studim në thellësi mbi bazat e Islamit (për të cilat ne shpesh nuk dimë gjë, por për të cilat ne flasim pa pasur gjë esenciale për të

* Pjesa e parë e librit të T. Ramadan, *Islam, the West and the Challenges of Modernity*, The Islamic Foundation, Leicester, 2004, f. 11-27.

¹ Revista *The Times* si dhe *L'Express*-i francez i kanë shtuar këto lloje titujsh.

² Ky ngatërrim në specializimin universitar po bëhet gjithnjë e më i shpeshtë. Specialistët e lëvizjeve socio-politike islame janë bërë specialistë të Islamit bashkëkohor. Krejt kjo po bëhet sikur muslimanët sot nuk po mendojnë më, nuk i rimendojnë burimet dhe pikat e referimit të tyre; tani e tutje ata janë të prirë vetëm të reagojnë.

thënë), i cili studim pastaj do të na mundësonte të vlerësonim nëse vërtet ekziston një papajtueshmëri midis Islamit dhe pranimit të parimeve të modernitetit ashtu siç kuptohen në Perëndim. Megjithatë, një studim i këtillë është një mjet për ta kuptuar bollëkun dhe begatinë e ideve të cilat i mobilizojnë sot njerëzit në shoqëritë muslimane. Kjo nga arsyeja për të krijuar një shoqëri e cila mund të jetojë me kohën e saj si në rrafshin ekonomik e politik ashtu edhe në atë shoqëror e kulturor, pa mos i mohuar ose tradhtuar pikat e saj të referimit.

I. Kur'ani dhe Sunneti³

Kur'ani për muslimanët është Fjala e Zotit që i është shpallur gradualisht pejgamberit Muhammed a.s. përgjatë 23 viteve të misionit të tij me ndërmjetësim të melekut Xhebrail.⁴ Prandaj, nga ky aspekt Kur'ani për ta paraqet një fjalë absolute e cila jep dhe merr kuptim përtej ngjarjeve dhe rastësive të historisë. Ai, për besimtarët muslimanë është mesazhi i fundit për njerëzimin i shpallur nga Zoti, i Cili në të kaluarën ka dërguar shumë profetë, ndër të cilët ka qenë edhe Nuh, Ibrahim, Musai dhe Isai a.s.. Teksti kur'anor para së gjithash është një përkujtues⁵ për njerëzimin në mënyrë që ata t'i rikthehen besimit origjinal në Zot dhe të përvetësojnë një sjellje të pranueshme morale. Më tepër se një e treta e Kur'anit përbëhet nga shprehja e "*tevhidit*": besimi në njëjësinë e Krijuesit, i Cili nuk është lindur dhe nuk ka lindur kënd. Ne gjithashtu gjejmë në Kur'an të përmenden historitë e pejgamberëve të tjerë, rrëfimet e të cilëve bartin faktin e esencës unike të mesazheve të ndryshme dhe të vazhdimësisë së tyre. Të gjitha këto pasazhe përçojnë *spiritualitetin* i cili duhet ta shoqërojë besimtarin: dimensionin e tyre absolut është logjik dhe i pranueshëm në vetvete. Një numër i ajeteve në Kur'an flasin për krijimin, universin, kurse ajete të tjera insistojnë në formën e raportit që njerëzit duhet ta krijojnë mes vete ose dhe me natyrën. Në fakt, Shpallja ka të bëjë me të gjitha sferat e aktivitetit njerëzor: me rendin ekonomik, me projektin shoqëror dhe me përfaqësimin politik. Pikërisht kjo veçanti është ajo e cila, në qoftë se nuk nënkuptohet në kontekstin e strategjisë kur'anore për ndryshim, mund të shkaktojë disa probleme. Fjala e Zotit është absolute dhe definitive, zbatimi i saj në situata të dhëna drejtohet nga rregullat e vendosura dhe nga një mekanizëm që siguron harmoninë midis objektivave dhe parimeve që qëndrojnë pas urdhrave dhe zbatimit të tyre specifik në situata të caktuara.

Kjo është mënyra se si pejgamberi Muhammed a.s., shokët e tij si dhe juristët e parë e kanë kuptuar atë. Kur'ani ka zbritur shkallë-shkallë dhe në ajete të shpallura që u janë adresuar situatave specifike me të cilat është dashur të ballafaqohet bashkësia e besimtarëve përreth Muhammedit a.s. dhe të cilat kanë pasur rëndësi universale. Si të tilla, këto ajete të shpallura në njërën anë kanë qenë përgjigje *relative* për fakte të

³ Sunneti apo të dhënat e përcjella nga Muhammedi a.s. përfshijnë krejt atë që ka thënë, ka vepruar apo që ka miratuar Muhammedi a.s. përgjatë jetës së tij. Përmbledhja e këtyre të dhënave si dhe verifikimi i përmbajtjes së tyre janë lëndë e një shkence, *shkencës së hadithit*. Kritika e saj sot është rafinuar shumë hollë dhe na mundëson një klasifikim të teksteve sipas shkallës së besueshmërisë së tyre. Këto hadithe konfirmojnë, qartësojnë dhe herë-herë i kompletojnë obligimet kur'anore, lejesat dhe ndalesat, të cilat e përbëjnë burimin primar të fesë islame.

⁴ Përafërsisht midis viteve 610 deri në 632 pas Isait a.s., datës së vdekjes së Muhammedit a.s.

⁵ Sipas ajetit kur'anor: „*Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij.*“ (15:9).

caktuara historike; mirëpo ato kanë përfaqësuar edhe *absoluten* e shpallur, kuptimin e përhershëm të formulimit, parimin e përgjithshëm që del nga po e njëjta përgjigje. Pikërisht kjo është ajo që nga ana e juristëve, pas Ebu Hanifes dhe Shafiut⁶, është quajtur me termin “mekasidu’sh-sheri’ah”: objektivat dhe parimet e orientimit të legjislaturës islame.

Është çështje e një konceptualizimi të mëvonshëm ajo që e kanë kuptuar dhe zbatuar natyrshëm Muhammedi a.s. dhe shokët e tij. Kur Omeri r.a., që vjen në krye të muslimanëve pas Ebu Bekrit, vendosi që në vitin e njohur si viti i krizës, ta pezullonte dënimin me prerje dore të vjedhësve, e ndoqi pikërisht parimin e shtruar më lart. Vazhdimi i zbatimit të këtij dënimi do të kishte nënkuptuar një tradhti të objektivave të Shpalljes, e cila vetë është absolute (edhe sikur kjo të dukej e shkurtër sa edhe një shkronjë e Kur’anit).⁷

Në Kur’an ka afërsisht 228 ajete (nga gjithsej 6.238) që kanë të bëjnë me legjislacionin e përgjithshëm (e drejta kushtetuese, kodi penal e civil, marrëdhëniet ndërkombëtare, rendi ekonomik etj.).⁸ Këto urdhëresa përbëjnë normat bazë të sjelljes dhe i përkufizojnë katër këndet brenda të cilëve funksionon legjislatura. Kjo është një mekanizëm për ndryshim dhe orientim zhvillimor. Ato janë parimet e përgjithshme dhe absolute⁹ të fshehura pas përgjigjeve specifike të dhëna banorëve të Gadishullit Arabik në shek. VII. Prandaj, Kur’ani ofron parime drejtuese, parime orientimi. Këto të fundit në esencë janë absolute, ngase për muslimanin ato kanë ardhur nga Krijuesi i Cili njeriut ia tregon rrugën (*Sheriatin*)¹⁰ që duhet ndjekur për t’i respektuar urdhrat e Tij. Këto parime janë pikë referimi për juristët, të cilët kanë përgjegjësinë që në të gjitha kohët dhe vendet të japin përgjigje në pajtim me mjedisin e tyre pa mos e tradhtuar orientimin fillestar. Kështu pra, nuk është çështje e refuzimit të zhvillimit të shoqërive, të ndryshimit të formave dhe mendësisë ose të diversitetit kulturor. Përkundrazi, muslimani është i obliguar ta respektojë Rendin Hyjnor, i cili Rend e ka dashur kohën, historinë dhe diversitetin.

“Ai krijon të gjallin prej të vdekurit dhe të vdekurin prej të gjallit, Ai e ngjall tokën pas vdekjes së saj, e po ashtu edhe ju do të nxirreni (të gjallë prej varrezave). Nga faktet (e fuqisë) e Tij është edhe ajo, se Ai ju krijoi prej dheu, e mandej ju (u zhvilluat në) njerëz që veproni të shpërndarë. Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë. Nga argumentet e

⁶ Emrat e të cilëve, pas vdekjes së tyre, u janë dhënë dy shkollave juridike.

⁷ Zbatimi i këtij dënimi kërkon kushte shumë të rrepta dhe sidomos një mjedis social i cili çdokujt ia jep atë që është jetësisht e domosdoshme. Vjedhja e motivuar nga nevoja nuk është po ajo vjedhje që nënkuptohet nga ajeti kur’anor.

⁸ Juristët kanë mendime të ndryshme lidhur me këtë çështje. Numërimi i „ajeteve legislative“ varet nga shkalla e interpretimit të bërë në kohën e leximit të tyre (disa prej tyre numërojnë – sipas interpretimeve më të gjera – deri në 600 ajete të këtilla).

⁹ Shkencat e Kur’anit (Ulumu’l-Kur’an) janë pafundësisht të gjera. Ato përfshijnë shumë fusha dhe kërkojnë lloje njohurish të sakta: përcaktimin e Shpalljeve mekase dhe medinase, shkaqet e shpalljeve (për shumicën e ajeteve), shfuqizimin (abrogimin) dhe ajetet e shfuqizuara, një zotërim perfekt i gjuhës arabe etj.

¹⁰ Përkundër përdorimit të zakonit të zbatuar në interpretimet e bëra në Perëndim, Sheriati nuk mund të reduktohet në kodin penal. Sigurisht që ky term është shumë më i gjerë dhe përfshinë, krahas formulimeve legislative, edhe parimin e besnikërisë ndaj Zotit, ndaj Pejgamberit të Tij dhe ndaj Shpalljes së Tij. Kjo besnikëri nuk mbështetet në literalizëm, siç jemi duke u munduar këtu ta tregojmë.

Tij është krijim i qiejve e i tokës, ndryshimi i gjuhëve tuaja dhe i ngjyrave tuaja. Edhe në këtë ka argumente për njerëz.” (Kur’ani, 30:19-22)

Fazat e krijimit të qiejve, të tokës dhe të qenies njerëzore si dhe shumëllojshmëria e gjuhëve dhe e racave janë shenja të Pranisë hyjnore, prandaj edhe duhen respektuar. Llojlojshmëria e të gjitha qenieve njerëzore ka të njëjtin kuptim:

“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se te All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat), e All-llahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.” (Kur’ani, 49:13)

Kështu, njeriu i cili ka besim, duhet të njohë, që në momentin kur ai është i zënë me punët e njerëzve, faktet e zhvillimit historik si dhe llojlojshmërinë e kulturave e të adhurimit. Të ballafaqohet me përgjegjësitë e tij si besimtar do të thotë ta kuptojë horizontin e këtij kompleksiteti dhe ta aktivizojë vetveten për të gjetur, për kohën dhe vendin e vet, mënyrën më të mirë për krijimin e harmonisë midis parimeve absolute dhe jetës së përditshme. Sunneti i Muhammedit a.s., burimi i dytë i së drejtës islame, ia mundëson njeriut arritjen e objektivave të Shpalljes. Në fakt, duke analizuar atë se çfarë ka thënë Muhammedi a.s. në këtë apo në atë rast, ose si ka vepruar ai, ose sërish si ka miratuar ai diçka, ne jemi në një pozitë më të mirë për ta kuptuar domethënien dhe shtrirjen e urdhëresave hyjnore.¹¹ Në të njëjtën mënyrë, juristët janë munduar që nga thëniet, veprat dhe vendimet e pejgamberit Muhammed a.s. të nxjerrin parimet që ua mundësojnë muslimanëve të jetojnë me kohën dhe mjedisin e tyre duke mbetur akoma besnikë ndaj mësimave të këtij Pejgamberi.

Në shikim të parë, referimi i vazhdueshëm në Kur’an dhe në Pejgamberin a.s. mund të duket si një pengesë dhe si një mohim i ndryshimit, dhe kjo manifestohet nga dëshira për ta parë të zbatohet një legjislacion që është i vjetër 14 shekuj. Megjithëkëtë, atë që tanimë e thamë është dëshmi për atë se kjo formë e të kuptuarit është shumë reduksioniste dhe nuk korrespondon as me mësimet e Muhammedit a.s. e as me qëndrimin e *ulemave* (dijetarëve) të epokës së parë të Islamit. Vendosja e parimeve të përgjithshme është një fakt që është dëshmuar në modalitetet e leximeve juridike të Kur’anit dhe haditheve, dhe konfirmon, nëse kjo lypet, kërkesën për “përpjekje për reflektim personal” (*ixhtihad*) në situata kur as Kur’ani e as Sunneti nuk japin përgjigje.¹²

¹¹ Muhammad Asad (Leopold Weiss, një çifut austriak i cili është konvertuar në Islam në vitet 1920 si dhe autor i shumë librave mbi Islamin dhe përkthyes i Kur’ani në gjuhën angleze) na përkujton se komentimi (tefsiri) më i mirë i Kur’anit është vetë jeta e Muhammedit a.s.

¹² Sa e sa herë kam dëgjuar vërejtjet lidhur me efektin që referimet konstante të Kur’anit dhe të thënieve të Muhammedit a.s. të çuakan në një fundamentalizëm relativ dhe se në këtë paska një burgosje të dyshimtë të mendimit, një autonomi të pamundshme për të menduarit e lirë. Këto vërejtje ndonjëherë bëhen nga të krishterët e përkushtuar (katolikë e protestantë) ose edhe nga intelektualë, të cilët në mënyrë shumë të vendosur e mbrojnë diversitetin kulturor, mirëpo që e gjejnë veten të shqetësuar e të mërzhitur nga kjo veçanti e mendimtarëve muslimanë. Megjithëkëtë, kjo është një veçori thelbësore e konceptit islam mbi botën, historinë dhe shoqërinë. Duke qenë pjesëmarrëse në lidhjen që ekziston midis Zotit dhe njeriut, pikat e referimit janë të pashmangshme në orientimin e mendimit (ky orientim në fakt është një e dhënë e besimit), mirëpo kjo assesi nuk e burgos mendimin. Përkundrazi, ato japin llogari për çështjen e domosdoshme – të kërkesës – të qëllimit të jetës, e cila duhet të rrijë në arsyen autonome. Kjo pa dyshim është një prej pikave bazë të konvergencës midis konceptimeve perëndimore dhe islame të lirisë dhe, së këndejmi, edhe të modernitetit. Për të parat kjo pikë referimi është një lidhje, një pengesë dhe një burg; për të dytat ajo është një lidhje, një identifikim dhe një çlirim.

II. *Ixhtihadi*: Midis absolutësisë së burimeve dhe relativitetit të historisë

Halifi i parë, Ebu Bekri r.a., kur duhej të shpallte një vendim, së pari i referohej Kur'anit dhe mendohej të gjente në mos kishte ndonjë tekst të zbatueshëm në të. Nëse nuk e gjente aty, atëherë i kthehej jetës së Muhammedit a.s. – sipas kujtesës së tij apo të as'habëve (shokëve të Muhammedit a.s.) – për të zbuluar një situatë të njëjtë për të cilën Pejgamberi a.s. mund të kishte marrë ndonjë vendim të caktuar. Në qoftë se në fund të këtij kërkimi këto dy burime nuk jepnin përgjigje për rastin në fjalë, ai i tubonte përfaqësuesit e popullit për t'u këshilluar me ta dhe pajtohej me ta për një vendim të ri, një vendim i cili racionalisht ishte i pavarur, por që e respektonte frymën e dy burimeve të para.

Kjo procedurë e shkallëpërshkallshme ka gjetur miratimin nga ana e vetë Muhammedit a.s. kur ai e dërgoi Muadh bin Xhebelin në Jemen për të marrë detyrën e gjykatësit. Në prag të nisjes së tij, Muhammedi a.s. e pyeti atë: “Në bazë të çkaje do të gjykosh?”, “Sipas Librit të All-llahut”, iu përgjigj Muadhi. “Në qoftë se nuk e gjen këtë brenda tij?”, iu përgjigj “Sipas traditës (sunnetit) të Pejgamberit të Zotit”. “Po në qoftë se as edhe aty nuk e gjen?”, tha “Atëherë do të mundohem që vetë të formuloj vendimin e nevojshëm”. Pasi e dëgjoi këtë përgjigje të Muadhit, Pejgamberi a.s. konkludoi: “I Madhëruar qoftë All-llahu, i Cili e udhëzoi të dërguarin e Pejgamberit në atë që është e pranueshme për Pejgamberin e All-llahut”.

Në fakt, gjërat janë shumë të qarta në çështjet legjislative. E drejta islame, për të cilën sot flitet aq shumë, në radhë të parë përbëhet nga të gjitha rregullat e përcaktuara në Kur'an dhe Sunnet. Për një hapësirë të shkurtër kohore, pasi u paraqitën disa çështje e sfida komplekse, juristët zhvilluan një metodë dhe vendosën parimet e kërkimit në fushën e së drejtës. Mu si në rastin e Muadhit, ata “të gjithë energjinë e tyre e vunë në formulimin e mendimeve personale”. Kjo detyrë e reflektimit në të drejtën islame njihet me emrin “*ixhtihad*”, një term arab që fjalë për fjalë do të thotë “të përpiqesh me gjithë energjinë për të arritur diçka”. Në mungesë të referencave tekstuale, është çështje e juristit që racionalisht të formulojë një rregull a normë në përputhje me kohën dhe vendin, mirëpo një rregull që nuk i tradhton mësimet dhe frymën e dy burimeve bazë.¹³ Me fjalë të tjera, përgjigjet i janë adaptuar kontekstit. Ato, vetëkuptohet, kanë qenë të ndryshme dhe të shumta, mirëpo gjithmonë “islame”, nëse nuk kanë rënë ndesh me ato parime të përgjithshme të pranuar në mënyrë unanime. Juristët janë të obliguar t'u përgjigjen pyetjeve të kohës së tyre duke i pasur parasysh realitetet sociale, ekonomike dhe politike të asaj kohe. Mu ashtu siç veproi Imam Shafiu kur e modifikoi përmbajtjen e jurisprudencës së tij (*fikhut*), pas udhëtimit që e bëri nga Bagdadi për në Kajro. Kur e pyetën për arsyen e këtij modifikimi duke qenë se Islami është një, ai u përgjigj se realitetet e Bagdadit dallonin nga ato të Kajros dhe se ligjet që ishin valide në një vend domosdo nuk janë të tilla në një vend tjetër. Ndryshe thënë, të vërtetën që e përçoi ai

¹³ Në fushën e gjerë të *ixhtihadit*, juristët kanë bërë dallimin midis llojeve të referencave juridike dhe kanë përcaktuar prioritetet. Kështu, arsyetimi me konsensus, ose *ixhmaja*, dhe arsyetimi me analogji, *kijasi* (po ashtu të shprehur me termat *ixhtihad ixhmaij* ose “përpjekje e të arsyetuarit kolektiv” për *ixhmanë* dhe *ixhtihad ferdij* ose “përpjekje e të arsyetuarit individual” për *kijasin*) konsiderohen si burimet më të përdorshme e më të zbatueshme pas Kur'anit dhe Sunnetit. Po ashtu, në fushën e kërkimit kemi edhe referenca shtesë, si marrja në konsideratë e interesit publik (*istislah*) ose integrimi i zakoneve (*'urf*). Juristët, edhe pse janë unanime sa i takon përparësisë së Kur'anit, Sunnetit dhe domosdoshmërisë së *ixhtihadit*, ata megjithëkëtë kanë mendime të ndryshme sa i takon statusit dhe saktësisë së metodologjive të referencave të tjera.

ishte se edhe pse shkronjat e Kur'anit e të Sunnetit janë një, zbatimi konkret i tyre është plural dhe kërkon adaptim.

Kjo punë e adaptimit, që është punë e juristëve dhe që njihet me emrin *fikh*, e rigrupon tërë jurisprudencën islame, si atë që ka të bëjë me aspektin e adhurimeve ashtu edhe me atë të punëve sociale. Në qoftë se rregullat që kodifikojnë adhurimet janë të pandryshueshme, kjo nuk është kështu kur të trajtohen çështjet sociale. Kur janë në pyetje këto të fundit, realitetet valëviten dhe *fikh*u, në qoftë se kuptohet drejtë, është një përgjigje e caktuar e dhënë në një moment të caktuar të historisë nga ana e një juristi i cili “ka bërë përpjekje” për të formuluar një legjislaturë islame. Ne duhet ta përshëndesim një punë të këtillë, mirëpo ne nuk duhet t'i shenjtërojmë vendimet dhe propozimet e juristëve. Çështja e zgjidhjes së problemeve të jetës moderne është një prej problemeve më të mëdha me të cilat ballafaqohen sot muslimanët.¹⁴ Ata shpesh ose e ngatërrojnë frymën e urdhrave të Kur'anit me kuptimin që ky apo ai jurist ua ka dhënë atyre në periudhën e parë të Islamit, ose u vjen shumë vështirë të hartojnë një legjislacion që buron nga burimet bazë por që në të njëjtën kohë realisht është në përputhje me kohën tonë.

Ne mund të shohim qartë, që nga fillimi e deri më sot, se Islami vazhdimisht ka kërkuar nga besimtarët e tij që në mënyrë konkrete dhe racionale ta mendojnë lidhjen e tyre me botën dhe me shoqërinë. Shumë orientalistë kanë theksuar se një prej veçantive të Islamit është edhe prioriteti që i është dhënë, që nga fillimi, reflektimit juridik krahasuar me të menduarit teologjik, dhe kjo nga arsyeja se Islami, në esencën e tij, e bashkon sferën private dhe publike dhe për çka, rrjedhimisht, është imponuar kërkimi i përgjigjeve konkrete. Ky bashkim ose përzjerje nxjerr në pah një koncept të veçantë të njeriut dhe universit.

Ne me këtë u munduam të tregojmë se në Islam nuk ka asgjë që e kundërshton konceptin e ndryshimit ose pranimin e progresit, mirëpo mbetet akoma të dëshmojnë veçoritë e konceptimit islam të qenies njerëzore dhe të universit. Në fakt, kjo është një çështje e analizimit të disa prej parimeve të përgjithshme e absolute, për çka kemi folur më lart, me qëllim që të vlerësohet se si ato mund të përçojnë një ide të caktuar të modernitetit, dhe të cilat assesi nuk do të asimilohen në realizimin e tyre perëndimor.

III. Zoti, krijimi dhe njeriu

1. Krijuesi dhe menaxhimi i krijesës

Ekzistimi i Një Zoti Krijues përbën besimin islam. Parimi që rrjedh nga kjo është se i gjithë universi i takon Zotit, i Cili, vetëkuptohet, është Pronari. Ne shpesh në Kur'an e gjejmë këtë shprehje:

“Vetëm të All-llahut janë gjithçka që ka në qiej dhe ç'ka në tokë...” (Kur'ani, 2:284)

Në të vërtetë ideja që përçohet në këto ajete e lidh dhe bashkon zotërimin hyjnor të qiejve e të tokës, dimensionin e shenjtë të qenieve dhe të elementeve të krijimit, dhe përfundimisht, kujtimin e fatit të njeriut:

¹⁴ Shiko “Shtojcën II: Problemet më të mëdha të sotshme të Islamit dhe të muslimanëve” të këtij libri.

“A nuk e di për All-llahun se Atij i lutet kush është në qiej e në tokë, madje edhe shpezët krahëhapura. Të gjithë e dinë dhe janë të udhëzuar për lutje ndaj Tij dhe për madhërimin ndaj Tij. All-llahu e di ç’punojnë ata. Vetëm i All-llahut është i tërë sundimi i qiejve e i tokës dhe vetëm te Ai është e ardhmja. A nuk e ke parë se si All-llahu i drejton retë, pastaj i bashkon, i bën grumbull ato edhe atëherë e sheh shiun se si rrjedh prej tyre. Ai lëshon prej së larti, nga retë e mëdha si kodra breshër dhe me të godet këdo, e ia largon atij që do. Shkëlqimi i vetëtimës së dritës së resë gati sa s’ta merr të parit. All-llahu bënë rrotullimin e natës e të ditës dhe në të gjitha këto ka fakte për ata që kanë të parit e shëndoshë.” (Kur’ani, 24:41-44)

Kështu, duke e kujtuar këtë dimension, besimtari kupton se i mbarë krijimi është i shenjtë dhe se ai këto elemente duhet t’i përdorë e shfrytëzojë me respekt e mirënjohje. Ai, siç thotë Kur’ani, është një menaxher që duhet të kujdeset për veprat e tij:

“Ai është që ju bëri sundues (zëvendësues) në tokë (pas shkatërrimit të atyre që ishin më parë) dhe lartësoi në një shkallë më të lartë disa nga ju mbi të tjerët, për t’ju sprovuar në atë që ju dha. All-llahu është Ndëshkues i shpejtë, është Falës e Mëshirues.” (Kur’ani, 6:165)

Kështu, njeriu jeton në një univers të gjitha elementet e të cilit janë shenja apo ajete, sa herë që ky ta kujtojë Zotin. Elementet janë të shenjta për aq kohë sa thirret kujtesa e besimit. Ato bëhen profane me rastin e harresës ose mospërfilljes. Kjo na tregon se sa e madhe është përgjegjësia e njeriut. Krahësigurimit të besimit, ai duhet të kujdeset edhe për menaxhimin e botës. Ky është kuptimi i krahësigurimit që e bën Kur’ani:

“Ne ua ofruam amanetin (obligimet) qiejve, tokës dhe maleve, e ato nuk deshën ta marrin përsipër atë dhe u frikësuan prej tij, ndërsa njeriu atë e mori mbi vete; dhe ai i bëri të padrejtë vetes, dhe ishte i padijshëm.” (Kur’ani, 33:72)

Njeriu sigurisht që është i lirë, mirëpo kjo është një liri që ka kërkesat dhe detyrat e veta në kuptimin më të plotë të fjalës.¹⁵

2. Leja bazë

Mbarë universi është vepër e Vullnetit të Zotit. Marrë absolutisht, kjo vepër është e mirë dhe shfaq të mirën për njeriun. Natyra e mirëpret atë dhe e drejton njëkohësisht. Është rregull bazë në Islam¹⁶ të theksohet përparësia e lejes – e me këtë edhe e lirisë – në raportin tonë me botën dhe me njerëzit. Kjo “leje bazë” (*el-ibaha el-aslijeh*) duhet të shprehet nga një e kuptuar e veçantë e qenies sonë në botë. Liria dhe pafajësia janë gjendjet e para të njeriut në një botë të hapur; akoma më ngushtë, në një botë të caktuar:

“Ai (All-llahu) është që për ju krijoi gjithçka që ka në tokë...” (Kur’ani, 2:29)

“A nuk e dini ju se All-llahu nënshtroi për të mirën tuaj ç’ka në qiej e ç’ka në tokë dhe plotësoi ndaj jush të mirat e Tij të dukshme e të fshehta?” (Kur’ani, 31:20)

Sipas kësaj, njeriu e koncepton universin, të cilit edhe i takon, si një dhuratë, kurse elementet e tij si të mira për ekzistimin e tij dhe si dëshmi për përgjegjësinë e tij. Fusha e

¹⁵ Dëshira e shprehur nga filozofi Michel Serres për ta parë natyrën – botën – si një subjekt të kontrollit natyror që duhet elaboruar, gjen jehonë të madhe në konceptin islam të raportit të njeriut me universin dhe elementet e tij. Krahësigurimit më poshtë, *Le contrat naturel*, 1988. Ne do t’u kthehemi sërish disa prej këtyre trajtimeve te Pjesa e Tretë e librit.

¹⁶ Në shkencën e parimeve të jurisprudencës (*ilmu usuli’l-fikh*), kodifikuesi i parë i së cilës ishte Imam esh-Shafiu (767-820).

së ndaluarës është shumë e kufizuar në krahasim me horizontin e së mundshmes (së lejuarës). Pikërisht kjo është ajo që e konfirmon leximi i Kur'anit dhe ajo që Muhammedi a.s. ua përkujton shokëve të tij të parë:

"... e Zoti yt nuk është që harron." (Kur'ani, 19:64)¹⁷

Në një hadith tjetër, Muhammedi a.s. ka thënë: "Zoti ka caktuar obligimet, mos i shpërfillni ato; Ai ka vënë kufij, mos i tejkaloni ato; Ai ka ndaluar disa sende, mos i shkelni ato. Ai ka heshtur për disa sende, si mirësi për ju, prandaj mos gjurmoni pas tyre".¹⁸ Ademi dhe Havva a.s., të dy përgjegjës për mosbindje ndaj një ndalese të vetme të caktuar nga Zoti, do të falen pas aktit të tyre. Kurse jeta në tokë do të jetë *një provim që burimin e ka në pafajësi dhe kuptimin e merr nga përgjegjësia*:

"E Ne i thamë: "O Adem, ti dhe bashkëshortja jote banoni në xhennet dhe hani lirisht nga frutat e tij kah të doni, por mos iu afroni asaj bime (peme) e të bëheni zullumqarë (të vetvetes suaj). Po djalli i bëri që ata të dy të mashtrohen në atë (peme) dhe i nxori ata nga ajo (e mirë) që ishin në te, e Ne u thamë: "Zbritni (dilni), jeni armik i njëri-tjetrit, e ju deri në një kohë në tokë keni vendbanim dhe dëfrim". E Ademi prej Zotit të vet pranoi disa fjalë (lutje), prandaj Ai ia fali (gabimin), Ai është Mëshirues dhe pranues i pendimit." (Kur'ani, 2:35-37).

Në këtë vend banimi të përkohshëm, që është toka, njeriu lind i pafajshëm, ndërkaq Shpalljet e njëpasnjëshme vijnë për t'ia shënuar atij rrugën (*Sheriatin*, në kuptimin e vërtetë të fjalës) dhe për t'ia caktuar kufijtë. Secili, në bazë të aftësive të tij, do të përgjigjet për respektimin e tyre dhe secili do të japë llogari për veprat e tij:

"All-llahu nuk e obligon asnjë njeri përtej mundësisë së tij..." (Kur'ani, 2:286)

"... e askush nuk do ta bartë barrën e tjetrit." (Kur'ani, 17:15)

Kështu është jeta dhe ky provim është fati i çdo njeriu që nga fillimi i kohës:

"Ai është që krijoi vdekjen dhe jetën, për t'ju provuar se cili prej jush është më vepërmirë. Ai është Ngadhënjyesi, Falësi i mëkateve." (Kur'ani, 67:2)

Në rrafshin juridik, kjo nënkupton një normë të imponuar në formën e leximit të Kur'anit dhe Sunnetit duke nënkuptuar se leja vjen në radhë të parë. Çdo gjë që nuk është e ndaluar qartë nga Zoti në fakt konsiderohet e lejuar.¹⁹ Ndalimi vepron edhe si një kufizim po edhe si një orientim. Sepse, duke vënë kufijtë, Krijuesi i zbulon njeriut dimensionin e kuptimit dhe ia tregon atij horizontin e vlerave, respektimi i të cilave ndërton humanitetin dhe dinjitetin e tij. Megjithëkëtë, ndalesat, nëse trajtohen si tërësi, janë të kufizuara. Ajo çka i mbetet njeriut, në kuptim të fushës së veprimtimit dhe angazhimit të tij, është pafundësisht e gjerë. Në këtë kuptim, Jusuf el-Kardavi ka të drejtë kur thotë se leja bazë nuk i mbulon vetëm elementet natyrore, ushqimet dhe pijet e ndryshme, porse edhe veprimet, shprehjet, zakonet e ndryshme, ndaj edhe punët sociale. Çdo gjë është e lejuar, përveç asaj që bie ndesh me normat e përcaktuara ose të njohura. Dinjiteti i njeriut, me kapacitetin e tij, priret të përziejë të dyja qëndrimet: t'i respektojë kufijtë dhe ta kthejë dhuratën e humanitetit të tij.

¹⁷ Transmetuar nga Hakimi.

¹⁸ Transmetuar nga Darekutni, Tirmidhiu, Ibni Maxheh dhe Hakimi.

¹⁹ Për këtë temë shiko hyrjen e shkëlqyeshme të veprës së Jusuf el-Kardavit, *The Lawful and the Prohibited in Islam* (Hallalli dhe harami në Islam), Londër: Shorouk International, 1985. Shiko edhe *Usulu't-teshri'il-islami* (Bazat e legjislaturës islame), Kajro, 1985.

“Ajo çka është e lejuar është e qartë, po edhe ajo çka është e ndaluar është e qartë, kurse midis tyre ka disa gjëra të dyshimta që nuk i dinë shumë njerëz. Kështu, ai që u largohet çështjeve të dyshimta e ruan veten nga aspekti i fesë dhe nderit të tij, kurse ai që futet në këto çështje të dyshimta bie në atë që është e palejueshme, sikurse çobani që e kullot bagëtinë e tij përreth një prone të huaj, pa mos lejuar të kullosin brenda saj. Vërtet secili mbret ka zonën e tij (të paprekshme), kurse zona e paprekshme e Zotit janë ndalesat e Tij. Me të vërtetë në trupin e njeriut gjendet një copë mishi, e cila nëse është e shëndoshë, i mbarë trupi do të jetë i shëndoshë, e nëse është e sëmurë, i mbarë trupi do të jetë i sëmurë. Kjo është zemra”²⁰

Vetëdija se universi është një mirësi ku ka rrugë dhuratash, leja dhe besueshmëria duhet të vijë në radhë të parë. Në njeriun ka një natyrë që është bekim. Ajo ia mundëson atij ta arrijë një qetësi që ndodhet në gurrën e faljes dhe dashurisë së Zotit. Vetëdija mbi kufijtë duhet të veprojë kështu edhe atë në bindjen e brendshme të të qenit përgjegjës para Zotit dhe jo në atë të epërsisë së fajësisë së tij.²¹

3. Të drejtat e Zotit dhe përgjegjësia e njerëzve

I tërë koncepti mbi njeriun që e ofron Islami, i raportit të tij me universin dhe me të tjerët, buron nga tri fundamentet që i prezantuan tanimë. Parimi i pronësisë së Krijuesit, ai i menaxhimit, brenda të cilit hy ideja e lejes bazë, përbëjnë esencën kryesore të fesë islame. “Nënshtrimi”, që është kuptimi i fjalëpërfjalshëm i fjalës “Islam”, që nga momenti kur shprehet besimi, përbën njohjen e këtij rendi thelbësor: të nënshtrohesh do të thotë të pranosh lirinë për të qenë njeri dhe përgjegjës para Krijuesit; do të thotë t’i përvetësosh kufijtë:

*“Këta janë kufijtë (dispozitat) e All-llahut, pra mos iu afroni atyre (mos i shkelni ato). Ja kështu, në këtë mënyrë All-llahu ua sqaron njerëzve argumentet e Veta që ata të ruhen.”*²² (Kur’ani, 2:187).

Rendi i universit dhe shenjtëria e elementeve që duhen respektuar, kufijtë që nuk duhen shkelur, në vetëdijen e besimtarit janë të drejta të Zotit mbi mbarë të krijuarën. Në Islam kjo vetëdije, që nga fillimi dhe përtej çdo përkatësie ndaj ndonjë feje të caktuar, është e karakterizuar nga njohja e transcendencës. Kushdo që niset në rrugën drejt origjinës, do ta gjejë në vetvete këtë aspiratë të natyrshme (*fitrah*) ndaj Zotit:

*“Përkujto kur Zoti Yt nxori nga shpina e bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri dëshmuar të vetes së tyre (duke u thënë): "A nuk jam Zoti juaj?" Ata thanë: "Po, dëshmuam!". Të mos thoni në ditën e kijametit: "Ne nga ky (dëshmim) ishim të panjohur".*²³ (Kur’ani, 7:172).

²⁰ Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.

²¹ Ideja e „mëkatit fillestar“ mungon në të gjitha referencat islame.

²² Hapja e kllapave në këtë ajet është e domosdoshme në mënyrë që t’i afrohem kuptimit në gjuhën arabe. Ideja e “ruajtjes” që përmendet në fund të këtij ajeti nuk është një pasqyrim i përkryer i “*takvasë, jettekun*”. Këtu, para së gjithash është çështje e intensitetit të besimit kur ai karakterizohet nga përvetësia dhe dashuria.

²³ Ky ajet është bërë lëndë e një numri të madh të komentimeve. Ai po ashtu ka qenë në qendër të interesimit të diskutimeve teologjike lidhur me konceptin “*fitrah*” – aspiratën natyrore të njeriut ndaj Zotit ose njohjen e esencës natyrore të nënshtrimit (*Islam*) ndaj Krijuesit. Sufijtë (mistikët muslimanë)

Është *përgjegjësi e njeriut* që jetën dhe lirinë e vet t'i bëjë dëshmi të përditshme të kësaj njohjeje. Sjellja e tij, me mend e gjeste, duhet të këndojë falënderimin ndaj Krijuesit të vet me të njëjtin psalm që e lëshon fërfërima e flatrave të zogut, ndërrimi i ditëve dhe i netëve ose e kokrrës kur plas jetë:

"Lartmadhëri të merituar i shprehin Atij shtatë qiejt e toka dhe çka ka në to, e nuk ka asnjë send që nuk e madhëron (nuk i bën tesbihë), duke i shprehur falënderim Atij, por ju nuk e kuptoni atë madhërim të tyre (pse nuk është në gjuhën tuaj). Ai është i butë dhe fal shumë." (Kur'ani, 17:44)

"S'ka dyshim, All-llahu është zbërthyes i farës (i kokrrës së saj) dhe i bërthamës (së pemës). Ai nxjerr të gjallin nga i vdekuri dhe Ai është nxjerrës i të vdekurit nga i gjalli. Ky është All-llahu, e si atëherë shmangeni (nga besimi)? Ai është krijues i dritës së mëngjesit. Natën e bëri kohë pushimi, e diellin dhe hënën për llogaritje të kohës. Ky (rregull) është caktim i të plotfuqishmit, i gjithëdijshmit. Ai është që krijoi yjet për ju që me ta të orientoheni në errësira kur jeni në tokë ose në det. Vërtet Ne i shpjeguam argumentet tona për një popull që di të mendojë. Ai është që ju krijoi (filloi) prej një njeriu; aty (mbi tokë) jetoni (qëndroni) dhe nën të do të pushoni. Ne ia sqaruam argumentet një populli që di të kuptojë." (Kur'ani, 6:95-98)

Të thuash se Zoti ka të drejta, do të thotë se esenca e njeriut përbëhet njëkohësisht edhe nga liria edhe nga përgjegjësia; me fjalë të tjera, njeriu e ka marrë përgjegjësinë – detyrën – për të dhënë llogari për lirinë e vet.

Ky formulim, që nga jashtë duket paradoksal, e shpreh mjaft mirë kuptimin e jetës së njeriut. Zoti e ka dashur rendin e botës ashtu siç është, Ai ka përcaktuar llojllojshmërinë e racave e të feve; kjo është shprehje e të drejtës së Tij. Njeriu, duke qenë i lirë, duhet ta njohë e respektojë këtë rend, respektivisht të drejtën e Zotit. Këtu perspektivat ne mund t'i shohim të përkundërta. Këtu nuk bëhet fjalë për *tolerancën*²⁴ që besimtari mund ta ketë me begeni kundruall të tjerëve. E drejta "për të qenë" i është dhënë çdokujt dhe është detyrë e çdokujt ndaj Zotit ta njohë atë. T'ia japësh vetvetes të drejtën të tolerosh, është tejkalim i kufirit ... së brendshmi është shkelje e së drejtës së Zotit:

"... Për secilin prej jush, Ne caktuam ligj e program (të posaçëm në çështje të veprimit). Sikur të donte All-llahu, do t'ju bënte një popull (në fe e shariat), por deshi t'ju sprovtojë në

e kanë komentuar dhe përdorur shumë këtë ajet. Ne këtu nuk kemi mundësi ta trajtojmë tërë problematikën që ka të bëjë me këtë çështje, por do të kufizohemi duke e nxjerrë në pah idenë bazë se, sipas Islamit, në secilin njeri ka një aspiratë, një energji që e orienton atë drejt Krijuesit. Kjo "tendencë" është pjesë e njeriut dhe e sjelljes së tij; ajo është një dëshmi (*shehadet*) natyrore. Kësaj ideje i bashkëngjitet pohimi i historianit të feve, Mircea Eliade, kur thotë se e shenjtja "është një element në strukturën e vetëdijes së njeriut". *Histoire des croyances et des idées religieuses*, Bibliothèque historique Payot, 1989, vëll. 1 [Përkthimi në anglisht, *A History of Religious Ideas*, përkth. Willard R. Trask, The University of Chicago Press]. Shiko edhe është Pjesën e Tretë të këtij libri.

²⁴ Toleranca, vetvetiu, shënon një raport force, baraspesha e të cilit është fakti i zgjedhjes së lirë të më të fuqishmit – ose të shumicës – dhe kjo është e barasvlershme me "durimin" e pranisë së tjetrit. Një shikim në historinë e mendësive, shoqërive dhe të fesë mund të na ndihmojë ta kuptojmë origjinën e këtij koncepti. Ai (koncepti i tolerancës) është zhvilluar nga filozofia racionaliste kur është diskutuar çështja e përcaktimit të qëndrimit të arsyeshëm të *më të fortit* ose të shumicës. Trajtimi i kësaj qasjeje kur është në pyetje *më i dobëti* – ose pakica – bën elaborimin e të drejtave të tyre. Dimension i pozitiv është i qartë këtu kur t'i shikojmë gjërat në planin historik. Mirëpo, në mungesë të një parimi bazë të obligimit (detyrës), ne vërejmë se këto formulime nuk kanë lejuar kuptimin e një shoqërie që mund të menaxhojë diversitetin sa në planin legjislativ po aq edhe në atë kulturor. Edhe atë pa mos e llogaritur faktin se ato nuk na mbrojnë nga teprimet e mostolerancës, që janë rezultat i thyerjeve sociale në Perëndim.

atë që jua dha juve, andaj ju (besimtarë) përpiquni për punë të mira. Kthimi i të gjithë juve është te All-llahu, e Ai do t'ju njoftojë me atë që kundërshtoheshit". (Kur'ani, 5:48)

Dallimet e njerëzve dhe kombeve, specifikat e kulturave dhe veçoritë e zakoneve janë dëshiruar nga Zoti. Kjo është një pasuri, mirëpo edhe një provim, ngase është e vështirë për njeriun ta kapë e ta jetojë dallimin në të gjitha aspektet. Kjo është një fakt dhe një sfidë. Kur'ani na sugjeron këtu se rruga më e mirë për ta trajtuar këtë aspekt të jetës së kësaj bote është të konkurrosh me njëri-tjetrin në të mirë. Dhe këtë, në të gjitha veprat dhe në thellësinë e mendimeve tona; me gjestet, fjalët dhe zemrat tona. Këtu nuk kërkohet toleranca, pasi në çdo gjë dhe para çdo kujt, në të gjitha horizontet dhe ngjyrat, nevojitet të dëshmohet urgjenca dhe domosdoshmëria e së vërtetës, e së mirës dhe e drejtësisë.

Nga anglishtja:
Mr. Rejhan Neziri